

VENDIM
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
“S.P.E GJADËR” SH.P.K

Sot, me datë 18. 03.2024, në selinë e shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k, u mbajt rregullisht dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, ”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “S.P.E GJADËR” sh.p.k”, person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne QKB, me datë 20.09.2013, me seli të ushtrimit të aktivitetit në Pasuria me Nr. 12/104, Rruga e Durrësit, ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 8310, Njësia Bashkiake nr. 11, Tiranë, i identifikuar me Nipt L32120012G.

Ne mbledhje jane prezent të gjithë ortakët e shoqërisë “S.P.E GJADËR” shpk, kuotat e të cilëve përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar dhe deklaruan paraprakisht se kanë marrë dijeni për zhvillimin e mbledhjes së sotme, pas njoftimit të rregullt të tyre konform dispozitave të LSHT, mbi njoftimet.

- **Shoqëria “Eues Energy” sh.p.k**, person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin Tregtar, me datë 06.08.2013, me seli te ushtrimit të aktivitetit në rruga “At Gjergj Fishta”, pallati 9-katësh, Rrëshen, Lezhë, me Nipt. L39406001N, përfaqësuar nga administrator Z. Gezim Prenga, atësia Gjon, amësia Marie, shtetas Shqiptar, lindur në Rrëshen, Mirditë dhe banues në TIRANË, me adresë Sulejman Delvina; Nd. 2; H. 1; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 04/05/1975, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033213896 dhe nr. personal H50504030W, **zotërues i 14 (katërmbëdhjete) % të kuotave në kapitalin themeltar;**
- **Shoqëria “Rafaëlo 2002” Sh.a**, person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne QKB, me date 13.09.2002, me seli te ushtrimit te aktivitetit në Pasuria me nr. 12/104, ZK 8310, Rruga “29 Nentori”, Njesia Bashkiake nr.11, Tirane, i identifikuar me NIPT K22113003Q, përfaqësuar nga administratori Z. aksionar mazhoritar i shoqerise sipas percaktimit te bere ne Vendimin e Asamblese Nr. 821 prot te dates 09.02.2016, Z. Mark Gjinaj atësia Ndue, shtetas Shqiptar, lindur në Lumbardhë, Pukë dhe banues në TIRANË, me adresë Gani Luzi; Nd. 16; H. 10; Ap. 39; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 10/03/1966, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034583309 dhe nr. personal G60310071N, **zotërues i 61 (gjashtedhjetë e një) % të kuotave në kapitalin themeltar;**
- **Shoqëria “S.P.E Energy” sh.p.k**, person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, me date 20.12.2012, me Nipt L22420002H, me seli të ushtrimit të aktivitetit, në “Kati i shtatë, Apartamenti nr. 11/7, Pallati “Harmonia”, Rr. “Teodor Keko”, Yzberisht, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga administrator Z. Erion Babameto, Erion Babameto, i datelindjes 08.06.1980 lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Nr, I00608121U Personal, **zotërues i 21 (njetzet e një) % të kuotave në kapitalin themeltar;**
- **Shoqëria “Vllaznimi” sh.p.k**, person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, me datë 01.09.1998, me seli të ushtrimit të aktivitetit, në rruga “Miqësia”, e ndodhur në pasurinë “Tokë-Arë”, me nr. pasurie 98/13, ZK. 8517, Spitalë, Lagja 15, Durrës, me Nipt. J88730336P, përfaqësuar nga administrator, Znj. Bardhe Jaku, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, lindur në datë 05 Tetor 1967, në Puke dhe banuese në Durrës, identifikuar me

letërnjoftimin ID, me nr. 032243759 dhe me nr. Personal G76005089G, zotërues i 4 (kater) % të kuotave në kapitalin themeltar;

Meqënëse ortakët e pranishëm përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) e kapitalit të shoqërisë, mbledhja mund të marrë vendimet e vlefshme mbi rendin e ditës shtruar për diskutim si më poshtë vijon:

1. Dhenien e aprovimit që shoqëria "Rafaelo 2002" sh.a, në cilesinë e ortakut të shoqërisë "S.P.E Gjader" të përballojë financimin dhe ndertimin e hidrocentraleve 1/1 dhe 1/2, në administrim të ortakeve koncensionar "Eues Energy" sh.p.k, "Vllaznimi" sh.p.k, "S.P.E Energy" sh.p.k, sipas pjesëmarrjes së tyre në kuota.
2. Përcaktimin e mënyrës së likuidimit të shoqërisë "Rafaelo 2002" sh.a për investimin e kryer.

VENDOSËN:

1. Dhenien e miratimit që shoqëria "Rafaelo 2002" sh.a, në cilesinë e ortakut të shoqërisë "S.P.E Gjader" sh.p.k të përballojë financimin dhe ndertimin e hidrocentraleve HEC 1/1 dhe HEC 1/2, në administrim të ortakeve koncensionar "Eues Energy" sh.p.k, "Vllaznimi" sh.p.k, dhe "S.P.E Energy" sh.p.k, sipas pjesëmarrjes së tyre në kuota.
2. Dhenien e miratimit që shoqëria "Rafaelo 2002" sh.a të likuidohet nepermjet konvertimit të kuotave të kapitalit të shoqërive të tjera ortakeve të Shoqërisë SPE –GJADER shpk, në favor të saj, duke përfituar në këtë mënyrë 100 % të prodhimit të Hec-ve të ndertuara nga kjo e fundit. Gjithashtu në momentin e perfundimit të investimit total palet detyrohen të mblidhen për të bërë rishikimin e të gjitha kuotave në proporcion të drejtë me investimin e realizuar dhe fuqinë e instaluar të Heceve-ve të të gjithë Kaskadës, të ndertuara në dhe në administrim të secilës pale. Rishikimi përfshin të gjithë ortakët koncensionar.

Duke mos patur çështje të tjera për diskutim dhe asnjë kërkesë tjetër për të diskutuar, pas miratimit të çështjes "rend dite", mbledhja u deklarua e mbyllur.

Ky vendim do të regjistrohet në regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë dhe do të pasqyrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT E SHOQËRISË "S.P.E GJADËR" SHPK

Shoqëria "EUES Energy" sh.p.k

Administrator

Z. Gezim Prenga

Gezim Prenga

Shoqëria "Rafaelo 2002" Sh.a

Aksionar mëzhoritar

Z. Mark Gjinaj



Shoqëria "S.P.E Energy" sh.p.k

Administrator

Z. Erion Babameto

Erion Babameto

Shoqëria "Vllaznimi" sh.p.k

Administrator

Znj. Bardhe Jaku

Bardhe Jaku

